

# AKTI I THEMELIMIT

## SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### “ATTA DENTAL” shpk

**Sterjo Kokoneshi** , i biri i Mihal , i datelindjes **23-07-1985** , banues ne **Kavaje shtetas Shqiptare** i identifikuar me numer **ID. I50723106T**, qe ne vijim do te quhet **“Ortak”**.

Sot me date **07-08-2022**, vendosa te themeloj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **“ATTA DENTAL” shpk** ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.


#### Kreu I

#### **OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

##### **Neni 1.Objekti i shoqerise**

##### **1.1.Shoqeria ka kete objekt veprimtarie;**

- Konsulencë dentare dhe asistence dentare, për llogari të vet ose klientë te ndryshem;
- Import -Eksport te materialeve dhe pajisjeve dentare, farmaceutike, mjekesore;
- Import -Eksport te medikamenteve te ndryshme mjekesore dhe farmaceutike;
- Import- Eksport i materialeve dhe pajisjeve stomatologjike dhe mjekesore
- Tregtimi me shumice e pakice i materialeve dhe pajisjeve stomatologjike dhe mjekesore etj;
- Tregtim I paisjeve dhe aparatura mjeksore e stomatologjike,prodhime kozmetike;
- Transmetimin e produkteve promocionale, transmetim te spoteve publicitare per vete dhe per te trete ne LED wall dhe ne platform ate tjera dixhitale , media sociale etj.
- Shoqeria gjithashtu mund te realizoje bashkepunime me shoqeri te tjera qe kane te njejtin objektiv ose te ngjashem me ate te shoqerise, si dhe ne raste te vecanta ne sektore te tjere, bashkepunime me persona fizike, vetem nese keto veprime jane te quajtura te nevojshme ose te duhura per realizimin e objektivit te shoqerise nga organi administrative
- Shoqëria mund të kryej cdo lloj aktiviteti tjetër që nuk është i ndaluar nga ligji shqiptar dhe që ka lidhje të mjaftushme me objektin e aktivitetit të saj.- pjesëmarrja, gjithashtu në bashkëpunim me palët e treta.



1.2. Shoqëria kryen çdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektivave të saj,

## **Neni 2. Emertimi dhe Selia juridike e Shoqërisë**

2.1. Ortaket e shoqërisë vendosen që shoqëria ta emertojë

### **“ATTA DENTAL” shpk**

2.2. Selia juridike e Shoqërisë ndodhet në : KAVAJE Lagjia nr 2, Rruga “Kristina Koliaka” ,ndertese 4 kateshe, kati 3 , Zona Kadastrale 8551 me Nr. Pasurie 4/245.

2.3. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare , filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

## **Neni 3**

### **Regjimi Juridik**

3.1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar kohore

## **Neni 4**

### **Te drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakëve**

4.1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj .

4.2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortakë në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

4.4. Shoqëria përgjigjet ndaj të tregëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.


4.5. Ortaket kanë të drejtë të marrin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike, etj

4.6. Ortaket kanë të drejtë të bëjnë propozime, si dhe emerojë e shkarkojë, administratorin ose administratoret, punonjësit, ekspertin kontabel, apo likuidatoret.

## **Neni 5**

### **Aktet e Shoqërisë**

2.1 Të gjitha dokumentat e nxjerra nga Shoqëria dhe që i drejtohen palëve të treta, si letra, fatura, njoftime, etj duhet të përmbajnë emrin e shoqërisë dhe inicialet "SH.P.K", numrin unik të identifikimit (NUIS), adresën e selisë, numrin e telefonit dhe adresën elektronike.



**PJESA II**  
**KAPITALI, KUOTAT, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

**Neni 6**  
**Kapitali i Shoqërisë**

3.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **100000 Lekë**. Pjesëmarrja e ortakut themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij si më poshtë:

- 1. Sterio Kokoneshi**, në cilësinë e ortakut themelues është zotëruar i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 100000 lek që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë me vlerë nominale 100000 lekë.

**Neni 7**  
**Transferimi i kuotave**

4.1 Kuotat janë lehtësisht të transferueshme sipas ligjit shqiptar në fuqi.

**Neni 8**  
**Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit**

5.1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit. Kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet më shumë se kufijtë e përcaktuar në ligj.


**PJESA III**  
**ORGANET E SHOQËRISË**

**Neni 9**  
**Asambleja e Përgjithshme**

6.1 Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.

9.2 Asambleja e përgjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët.

9.3 Asambleja e përgjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:

- a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
  - b) pranimin e ortakëve të rinj;
  - c) largimin/përfundimin e një ortaku, në përputhje me dispozitat statutore në fuqi;
- 

- d) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencionit të dhënë nga ortakët;
- e) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
- f) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
- g) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit;
- h) miratimin e raporteve vjetorë dhe bilancit të shoqërisë si dhe shpërndarjen e fitimit;
- i) blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
- j) marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e cdo të drejte për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
- k) të vendosë për investimet;
- l) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie
- m) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
- n) të delegoj apo revokojë një prokurë apo autorizim për të vepruar në emër të shoqërisë;
- o) të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
- p) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose cdo pagese mbi largimin e drejtorëve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
- q) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
- r) emerimin dhe shkarkimin e likujduesve, ekspertëve kontabël të autorizuar;
- s) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin;
- t) të ngre padi kundër anëtarëve të organeve të shoqërisë ose kundër ortakëve të tjerë;
- u) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
- v) përcaktimin e buxhetit vjetor;
- w) miratimin e cdo çështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së përgjithshme në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.

9.4 Asambleja e përgjithshme mund të thirret nga administratorët ose nga ortaku/ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 % të kapitalit të shoqërisë, të paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose në cdo vend tjetër nëse përcaktohet në njoftim. Asambleja e përgjithshme do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratorët, njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande, telexi apo faksi jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë. Gjithashtu, asambleja e përgjithshme mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njëjtat kushte dhe afate.

9.5 Për cdo mbledhje të asamblese së përgjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregëtar dhe një për secilin ortak. Procesverbali i bashkëngjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme. Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

**Neni 10**  
**Të drejtat dhe detyrimet e ortakëve**


- 10.1 Ortakët janë përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet. Ortakët do të ushtrojnë të drejtën e tyre për të marrë pjesë në vendimmarrjen e shoqërisë në mbledhjen e ortakëve. Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë personalisht ose me prokurë, të informohet mbi çështjet e shoqërisë dhe të kontrolloj dhe auditoj librat dhe regjistrat e shoqërisë.
- 10.2 Ortakët janë të detyruar të paguajnë kuotën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë, nëse thirren rregullisht, të ndihmojnë shoqërinë në ushtrimin e aktivitetit dhe në zbatimin e vendimeve të mbledhjes së asamblesë dhe organeve të tjera të shoqërisë, që janë miratuar brenda kompetencave të autoritetit përkatës.

**Neni 11**  
**Administrimi i Shoqërisë**

- 11.1 Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë administratorë.
- 11.2 Administratorët emërohen për një periudhë 5 (pesë) vjeçare e cila është e rinovueshme.
- 11.3 Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Përgjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 11.4 Shoqëria do të drejtohet nga Administratori si më poshtë:  
1. Sterio Kokoneshi i biri i Mihalit, i datëlindjes 23-07-1985 lindur në Durrës dhe banues në Kavajë, identifikuar me Nr. Personal ID I50723106T .

**Neni 12**  
**Largimi i Administratorit**

- 12.1 Detyra e Administratorit përfundon në rastet vijuese :
- a) sipas parashikimit të ligjit;
  - b) kur ka paaftësi paguese;
  - c) është apo mund të vuajë nga crregullime mendore;
  - d) jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar për këtë Shoqërinë;
  - e) është zhdukur nga zyra pa dhënë arsye për më shumë së 6 (gjashtë) muaj dhe Asambleja e Përgjithshme vendos për largimin nga detyra;
  - f) kur përfundon mandati i tij dhe Asambleja e Përgjithshme nuk e rimemëron atë.



**Neni 13**  
**Viti Financiar**

13.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 dhjetor të cdo viti

**Neni 14**  
**Pasqyrat financiare**

- 14.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari dhe raportet e Administratorit/ Këshillit të Administrimit si edhe Ekspertëve Kontabël, paraqitën në Asamblenë e Përgjithshme për pranim dhe miratim.
- 14.2 Dokumentat në lidhje me vitin financiar, duhet të miratohen brënda 6 (gjashtë) muajve nga mbarimi i vitit financiar.

**Neni 15**  
**Dividendi**

15.1 Pas miratimit të pasqyrave financiare vjetore, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për shpërndarjen e dividendit tek ortakët e Shoqërisë.

**Neni 16**  
**Fitimi i Shoqërisë**

16.1 Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga asambleja e otakëve dhe do të dorëzohet në organet tatimore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

**LIKUIDIMI**


**Neni 17**

17.1 Në rastin e likuidimit do të zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare. Normat për kryerjen e likuidimit dhe emërimin e likuiditorit do të vendosen nga Asambleja e Përgjithshme.

**Neni 18**  
**Dispozita përfundimtare**

18.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, palët do të përpiqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e palëve do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë.

18.2 Ky Statut u hartua në kater kopje dhe u lexua, pranua dhe u nënshkrua nga Ortakët në datën e sipërmendur.



Emrat dhe Nënshkrimet e Ortakëve:

Sterjo Kokoneshi

